



ZYRA E BANKES BOTERORE, Tiranë

Thirrje për Projekte në kuadrin e Programit të Granteve të Vogla

Programi i Granteve të Vogla mundëson Bankën Botërore të promovojë dialogun dhe shpërndarjen e informacionit tek organizatat jofitimprurëse për zhvillimin e forumeve jashtë fushës së aktivitetit të saj. Objektivi i Granteve të Vogla për vitin 2003 përqëndrohet në *fuqizimin e angazhimit qytetar të grupeve të mënjanuara dhe të rrezikuara të popullsisë për t'u përfaqësuar edhe ato në proceset e zhvillimit.*

Zyra e Bankës Botërore në Tiranë ju fton të paraqisni projekte që trajtojnë:

- Mundësimin e informacionit dhe lidhjeve të grupeve të rrezikuara të popullsisë me organizata/institucione të tjera;
- Ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi nevojat e këtyre shtresave të mënjanuara;
- Rritjen e kapacitetit të këtyre grupeve për të influencuar opinionin publik dhe për të negociuar me pushtetin qendror dhe atë vendor;
- Nxitjen e integritit shoqëror të grupeve të përjashtuara dhe të rrezikuara;
- Nxitjen e proceseve pjesëmarrëse të këtyre grupeve në vendimmarrje;
- Rishikimin e kuadrit ligjor mbi angazhimin qytetar dhe fuqizimin e grupeve të mënjanuara. Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor të duhur mbi angazhimin qytetar.

Janë të ftuar të aplikojnë në këtë program organizata vendase të shoqërisë civile. Të interesuarit mund të paraqiten për të tërhequr format e aplikimit dhe informacione të tjera mbi kriteret e aplikimit pranë Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë. Ky informacion është vendosur edhe në faqen e internetit: www.worldbank.org.al.

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera të nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf pranë Zyrës së Bankës Botërore në adresë të Koordinatorit të Programit të Granteve të Vogla jo më vonë se 15 Shkurt 2003.

Adresa:

Koordinatori i Programit të Granteve të Vogla

Banka Botërore

Rruga “Dëshmoret e 4 shkurtit”, Nr. 34

Tel: 042 405 87/88/89

Fax: 042 405 90

Tiranë